



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS

Kuvendi i Komunës

Nr.02/555

Datë: 16.11.2022

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika (d), nenit 40 paragrafi 2 pika d, nenit 53 paragrafi 2, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/ 15, qeshor 2008", në bazë të nenit 10, nenit 19 dhe nenit 28, të Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871 datë:12.11.2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e –VIII-(tetë) të rregullt të mbajtur me datë: 10.11.2022 merr këtë:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS TË KOMITETIT PËR BARAZI GJINORE PËR VITIN 2022

1. Miratohet Plani i punës nr.02/518 datë:01.11.2022 i Komitetit për Barazi Gjinore për vitin 2022.
2. Plani i punës për vitin 2022 përfshinë gjithë punën dhe aktivitetet e përcaktuar nga Komiteti për Barazi Gjinore.
3. Pjesë përbërse e këtij vendimi është Plani i punës për Komitetin për Barazi Gjinore.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryesuesi i Kuvendit, përmes Komitetit për Barazi Gjinore.
5. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas dërgimit në auteritetin mbikqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin e Administrativ të Akteve të Komunave, dhe pas shpalljes në ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet :
MAPL-së
Arkivit të Komunës
Anëtarëve të Komitetit





REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA MALISHEVË

LËNDA: PLANI I PUNËS SË KOMITETIT PËR BARAZI GJINORE

NGA: KOMITETI PËR BARAZI GJINORE

PËR: KUVENDIN KOMUNAL MALISHEVË

Pranuar me: _____



PRANUAR MË:

ACCEPTED ON: 01/11/2022

PRIMLJENO:

Nr.No.Br. 02/518

Komiteti për Barazi Gjinore, duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisjen lokale si dhe statutin e Komunës së Malishevës, Kuvendi Komunal Malishevë ka marrë vendim për themelimin e Komitetit për Barazi Gjinore. Ky Komitet përbëhet nga 5 anëtar: Valjeta Hoti, Amrush Helshani, Fatime Limaj, Zade Zogaj dhe Adile Hoxha. Konstituimi i këtij Komiteti është bërë në muajin Tetor, dhe plani i punës së këtij Komiteti për vitin 2022 dhe aktiviteti i tij është plotësisht i bazuar në muajt Tetor, Nëntor dhe Dhjetor. Në këtë plan në mënyrë shumë të qartë i gjeni edhe aktivitetet e parapara për këta muaj. Ne si Komitet kërkojmë nga Kuvendi Komunal miratimin e këtij plani.

Plani I Punës së Komitetit për Barazi Gjinore për vitin 2022

OBJEKTIVAT	AKTIVITETET	PERIUDHA KOHORE	DETAJE TJERA
Muaji Rozë,Muaji i ndërgjegjësimit për Kancerin e Gjirit.	Ky muaj të shenohet me thirrje të njëpasnjëshme për kontrolle mjeksore,të pasurohet webfaqja e Komunës me postime dhe aktivitete që i pergjigjen këtij muaji.Komuna t'u bëjë thirrje mediave lokale që të ketë sa më shumë spote dhe reklama më qëllim të vetëdijesimit te Grave. Vizitë Grave me Kancer. Organizimi i një ligjerate në nivel Komunal në bashkëpunim me zyren për barazi gjinore,me Doktor të kësaj fushe si dhe me Grat të cilat e kanë fituar luftën me Kancerin e Gjirit.	Tetor	Bashkëpunimi me Institucionet Komunale,Drejtorinë e Shendetësis dhe QKMF-të.

Shqyrtimi I raportit të punës së Zyres për Barazi Gjinore.	Takim me Zyrtaren për Barazi Gjinore.	Nëntor	
Rekomandime rreth aktiviteteve me të cilat shenohen këto ditë.	Shenimi I 16 ditëshit I aktivizimit për sensibilizimin kundër dhunes dhe diskriminimit Gjinator.	Nëntor	Organizimi I takimit të Komitetit për Barazi Gjinore për përgaditjen e agjendes.
Shqyrtimi I raportit nga takimi me Komandantin e Policisë.	Takim me Komandantin e Policisë.	Dhjetor	
Rekomandime rreth aktiviteteve per shenimin e Ditës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut.	Shenimi I ditës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut (10 Dhjetor).	Dhjetor	Përgaditja e raportit të punës së Komitetit për Barazi Gjinore.

Discover
HP Accessories
www.hp.com/go/accessories



Kryesuesja e Komitetit për Barazi Gjinore

Valjeta H

